



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.\_\_.2024

**VENDIM**

**Nr. 18, datë 18.01.2024**

**PËR**

**MIRATIMIN E PROGRAMIT TË VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL  
TË GJYQTARËVE PËR VITIN 2024**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 147, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 2, 68-72, 74-78, 84-95 dhe 171 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263 dt. 21.11.2019 “Rregullat plotësuese të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve” dhe nr. 264 datë 21.11.2019 “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e programit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve për vitin 2024, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi e pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

**PROGRAM**

**I VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARËVE PËR VITIN  
2024**

Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ), bazuar në 85/1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, brenda muajit nëntor të çdo viti, duhet të miratojë programin me listën e gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave, për të cilët do të kryhet vlerësimi etik dhe profesional përgjatë vitit pasardhës, bashkë me përcaktimin e periudhës së vlerësimit.

Qëllimi i këtij programi është përgatitja paraprakisht e një plani pune me emrat e gjyqtarëve që do të vlerësohen përgjatë vitit 2024, por nuk nënkupton fillimin e procesit të vlerësimit. Miratimi i këtij programi iu shërben gjithashtu Kryetarëve e Kancelarëve të gjykatave, që të organizojnë punën për plotësimin e tabelave statistikore e dërgimin e tyre në KLGJ, brenda muajit janar, para se të fillojë procesi i vlerësimit për secilin gjyqtar të përfshirë në këtë listë.

Skema e Vlerësimit Etik dhe Profesional të Gjyqtarëve është plotësuar tashmë me të gjithë aktet nënligjore dhe është tërësisht e zbatueshme për gjyqtarët në detyrë si dhe për gjyqtarët e komanduar në KLGJ, të miratuar së fundmi me vendimin nr. 159, datë 05.04.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Veç tyre, mbeten ende prioritete për Këshillin, miratimi i rregullave plotësuese të skemës së vlerësimit për kryetarët e gjykatave.

Projekt-programi i vlerësimit etik dhe profesional për vitin 2024 është konceptuar i ndarë në 4/pjesë, si më poshtë :

**I. Gjendja e procedurave të vlerësimit të filluara deri tani.**

Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, në zbatim të nenit 171, pika 5 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, ka administruar dosjet me aktet e vlerësimit profesional për gjyqtarët që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, përcjellë nga organet e rivlerësimit pranë Këshillit, pasi vendimet respektive për secilin gjyqtar kanë marrë formë të prerë dhe ka kryer deri më tani vlerësimin e gjyqtarëve për këtë periudhë gjithësej 71 gradime, kanë

përfunduar pa vendim përfundimtar për shkak të pamundësisë së kryerjes së vlerësimit për këtë periudhë për 13 gjyqtarë. Gjithashtu, kanë përfunduar në komision gjithësej 6 gradime dhe materialet i kanë kaluar Mbledhjes Plenare.

Gjithashtu, lidhur me vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve, sipas programeve të vlerësimeve të miratuar me vendimin nga Këshilli, ku dy programet e fundit janë miratuar përkatësisht me vendimin me nr. 645, datë 23.12.2020 që i përket vitit 2021, si dhe me vendimin nr. 561, datë 29.12.2022, që i përket periudhës së vlerësimit të vitit 2023, ku janë përfshirë vlerësimi i zakonshëm për një periudhë 3 vjeçare sipas nenit 85 të ligjit “Për statusin” si dhe vlerësimi i përsheptuar kur është kërkuar nga gjyqtari, ngritja në detyrë sipas nenit 97 të ligjit “Për statusin”, rezulton se kanë përfunduar së vlerësuar 81 gjyqtarë, ndërsa për 3 gjyqtarë është deklaruar e mbyllur pa vendim përfundimtar procedura e vlerësimit për shkak të rënies së shkakut për fillimin e procedurës së vlerësimit të përsheptuar të detyruar. Gjithashtu, kanë përfunduar në komision gjithësej 4 vlerësime të zakonshme (për një periudhë 3 vjeçare) dhe materialet i kanë kaluar Mbledhjes Plenare.

Në programin e vlerësimit të vitit 2021, janë përfshirë në vlerësim, për periudhën 3/vjeçare të vlerësimit 2017-2019, duke përfshirë në program 52 gjyqtarë si dhe duke përcaktuar prioritetet e planifikimeve 3 mujore.

Konkretisht, me vendimin nr.177, datë 29.04.2021 të KLGJ ka filluar procedura e vlerësimit etik dhe profesional për 24 (njëzet e katër) gjyqtarë, për periudhën e vlerësimit 2017-2019, pjesë e programit të vlerësimit 2021, kjo duke marrë në konsideratë rendin e përparësive të përcaktuar në pikën 4 të vendimit nr. 645, datë 23.12.2021, ndërsa për 28 (njëzet e tetë) gjyqtarët e mbetur pjesë e programit të vlerësimit, nuk ka filluar procedura e vlerësimit etik dhe profesional për 9 (nëntë) prej tyre, për shkak se 2 (dy) gjyqtarë nuk gëzojnë më statusin e magjistratit, 6 (gjashtë) gjyqtarë nuk ushtrojnë funksionin e gjyqtarit për shkak të aplikimit të masës së “Shkarkimit nga detyra”, nga Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe 1 (një) gjyqtar është vlerësuar me procedurë të përsheptuar të detyruar etik dhe profesional për vitin e fundit të ushtrimit të detyrës (viti 2019), për shkak të kandidimit për ngritje në detyrë. Me vendimin nr.371, datë 13.09.2022 të KLGJ ka filluar procedura e vlerësimit etik dhe profesional për 19 (nëntëmbëdhjetë) gjyqtarët e mbetur, pjesë e programit të vlerësimit. Pra të gjithë gjyqtarët që gëzojnë statusin e gjyqtarit dhe ndaj të cilët nuk është aplikuar masa e “Shkarkimit nga detyra” nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, të cilët janë përfshirë në programin e vitit 2021 ka filluar procedura e vlerësimit etik dhe profesional.

Në programin e vlerësimit të vitit 2023, janë përfshirë në vlerësim, për periudhën 3/vjeçare të vlerësimit 2020-2022, duke u përfshirë në program 9 gjyqtarë, si dhe duke përcaktuar prioritetet e planifikimeve 3 mujore. Me vendimin nr. 173 datë 18.04.2023 të Këshillit të Lartë gjyqësor ka filluar procedura e vlerësimit për këta gjyqtarë dhe deri më tani ka përfunduar vlerësimi vetëm për një gjyqtare, ndërsa për 8 të tjerët vlerësimi është në fazën e plotësimit të dosjes së vlerësimit, në kushtet kur për të gjithë ka përfunduar faza e shortit për përcaktimin e dosjeve për vlerësimin etik dhe profesional.

Gjithashtu, gjatë kësaj kohe kanë filluar procedurat e gradimit të gjyqtarëve, të konfirmuar në detyrë me vendim të formës së prerë, menjëherë pasi janë dërguar nga organet e rivlerësimit dosjet e vlerësimit, sikundër është vepruar çdo vit. Konkretisht me vendimin nr. 81, datë 16.02.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor ka filluar procedura e vlerësimit për periudhën e gradimit për 20 gjyqtarë, ndërsa me vendimin nr.523, datë 05.10.2023 ka filluar procedura e vlerësimit për periudhën e gradimit për 17 gjyqtarë të tjerë. Gjatë kësaj periudhe, me vendim të Këshillit, kanë filluar procedurat e vlerësimit të përshpejtuar të detyruar për gjyqtarët që kanë aplikuar për ngritje në detyrë dhe për lëvizje paralele, për vitin e vlerësimit 2019 dhe 2022 për 12 gjyqtarë<sup>1</sup>, si dhe ka filluar procedura e vlerësimit për 4 gjyqtarë të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësore, pas miratimit të rregullave për vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve të komanduar në Këshill.

Në tërësi, kanë filluar dhe janë në proces, procedurat e vlerësimit si më poshtë:

- Vlerësim me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013-2016 – 36 gjyqtarë, prej të cilëve për 4 (katër) gjyqtarë ka përfunduar procedura e vlerësimit nga komisioni dhe janë përcjellë Këshillit për plenare;
- Vlerësim 3/vjeçar për periudhën e vlerësimit 2017-2019 dhe 2020-2022 – 25 gjyqtar, prej të cilëve për 2 (dy) gjyqtarë ka përfunduar procedura e vlerësimit nga komisioni dhe është përcjellë Këshillit për plenare dhe për 1 (një) është pezulluar procedura e vlerësimit;
- Vlerësimi i përshpejtuar i detyruar për vitin kalendarik 2019, 2021 dhe 2022- 7 gjyqtarë.
- Vlerësimi i gjyqtarëve të komanduar në Këshill - 2 gjyqtarë.

Gjithashtu, në funksion të trajtimit të kërkesës me nr. 5332/1 prot., datë 11.10.2022 të Gjykatës së Lartë për konfirmimin e gjyqtares Ina Hoxhaj në pozicionin e ndihmësmagjistrates në Gjykatën e Lartë, për një periudhë tjetër 3 vjeçare, me vendimin nr. 441, datë 01.11.2022, ka filluar procedura e vlerësimit etik dhe profesional për ndihmësmagjistraten për periudhën për periudhën 3 vjeçare 2018-2020, për të cilën ka përfunduar vlerësimi etik dhe profesional me vendimin nr. 7, datë 18.01.2023.

KVEVP i ndërgjegjshëm për rëndësinë që ka realizimi në kohë i programit të vlerësimeve, ka qenë në pamundësi objektive për të përfunduar procedurat e vlerësimit të filluara si më sipër, për shkak të disa faktorëve të tillë si : Fillimin dhe përfundimin me përparësi të vlerësimeve për periudhën e gradimit dhe të vlerësimit të detyruar të përshpejtuar për gjyqtarët që kanë aplikuar për ngritje në detyrë dhe lëvizje paralele në procedurat e hapura nga Këshilli, ku numri i aplikantëve ka qenë i lartë, numrit të nëpunësve përgjegjës të angazhuar në procesin e vlerësimit, volumit të punës të procesit të vlerësimit etik dhe profesional apo pritjes për kryerjen nga ILD të verifikimit të ankesave të paraqitura për gjyqtarët në proces vlerësimi.

---

<sup>1</sup> Të miratuar me vendimin nr.144, datë 28.03.2023, me vendimin nr.325, datë 14.06.2023 si dhe me vendimin nr.326, datë 14.06.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

## **II. Përcaktimi i listës së gjyqtarëve dhe periudhës së vlerësimit etik dhe profesional për vitin 2024.**

Në zbatim të nenit 85 të Ligjit “Për statusin”, programi i vlerësimit duhet ndërtuar në mënyrë të tillë që të sigurojë vlerësimin etik dhe profesional në kohë të gjyqtarit. Objektivat për zhvillimin profesional të gjyqtarit, duhet t’i përgjigjen nevojave reale të dala nga vlerësimi i punës së tij, me qëllim që rekomandimet për përmirësim të jenë koherente dhe të mundshme për tu realizuar. Inkoherenca midis vlerësimit dhe promovimit të gjyqtarëve duhet minimizuar gjithashtu. Nga ana tjetër, vlerësimi duhet të mbulojë të gjithë përvojën profesionale të gjyqtarit.

Bazuar në parimet e mësipërme, vlerësimi periodik i gjyqtarëve, kryhet 1 herë në 3 vjet për gjyqtarët me më pak se 15 vjet përvojë profesionale dhe 1 herë në 5 vjet për gjyqtarët që kanë përvojë profesionale mbi 15 vjet. Në kushtet kur periudha e rivlerësimit kalimtar 2013-2016, për efekt të ligjit, konsiderohet periudhë vlerësimi për gjyqtarin që konfirmohet në detyrë, vlerësim që përfundon me gradimin e gjyqtarit (niveli i vlerësimit), fillimi i vitit të parë mbi të cilin duhet të llogariten periudhat e mëpasshme të vlerësimit 3 apo 5/vjeçare, është viti 2017 (01.01.2017). Në datë 31.12.2021, është plotësuar periudha e vlerësimit 5/vjeçar, por, për këta gjyqtarë, në eventualitetin e aplikimit të tyre për lëvizje paralele apo ngritje në detyrë, nga ana e Këshillit, sipas një programi të veçantë, do të jenë subjekt të vlerësimit të përshpejtuar të detyruar për periudhën e vlerësimit referuar vitit të paraqitjes së kërkesës, që mund të jetë edhe periudha 01.01.2023-31.12.2023. Aktualisht, kanë aplikuar për ngritje në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, sa i përket vakancës së hapur me Vendimin nr.178, datë 11.05.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor 8 gjyqtarë, për të cilët vetëm për 6 prej tyre ka filluar procedura e vlerësimit të përshpejtuar sipas nenit 97 të ligjit “Për statusin” dhe aktualisht ka përfunduar vlerësimi i përshpejtuar për 4 prej tyre, ndërsa për 2 gjyqtarë procedura ende nuk ka përfunduar, e ndërvarur kjo edhe për shkak të mospërfundimit të procedurës së kualifikimit të tyre. Me vendimet e Këshillit të datës 24.11.2022 janë hapur 6 procedura të ngritjes në detyrë, nga të cilat 3 procedura për ngritje në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe 3 procedura për ngritje në detyrë në gjykatat e apelit, për të cilët për 11 gjyqtarë kanë filluar më parë procedurat e vlerësimit dhe për 7 kanë filluar procedura e vlerësimit të përshpejtuar sipas nenit 97 të Ligjit “Për statusin”, ndërsa për 1 gjyqtare ka filluar procedura e vlerësimit për periudhën e komandimit në Këshilli deri në datën e paraqitjes së kërkesës për ngritje në detyrë. Gjithashtu, me vendimet e datës 18.01.2023 Këshilli ka hapur 14 procedura të lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Durrës/ të vijuar për Gjykatat e Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë dhe Durrës, për të cilat vetëm për 2 kishte vlerësime të mëparshme të përfunduar, për 18 gjyqtarë kishte filluar më parë procedura e vlerësimit, ndërsa për 4 ka filluar procedura e vlerësimit të përshpejtuar të detyruar për vitin 2022. Nga këto procedura rezulton se ka përfunduar vlerësimin gjatë vitit 2023 për 11 gjyqtarë<sup>2</sup>. Ka filluar procedura e vlerësimit dhe janë në

---

<sup>2</sup> Vlerësimi i fundit i miratuar me vendimin nr.708, datë 04.12.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

pritje të plotësimit të dosjes apo të hartimit të raportit analitik dhe të projektraportit vlerësimi për 8 gjyqtarë.

Gjatë vitit 2023, konkretisht me vendimet e datës 24.05.2023 janë hapur 9 procedura të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe 4 procedura të ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, ku kanë kandiduar gjithësej 36 gjyqtarë. Për 6 gjyqtarë ka përfunduar procedura e vlerësimit më parë ose gjatë vitit 2023, ndërsa për 7 ka filluar më parë procedura e vlerësimit të zakonshëm apo të përshpejtuar për shkak të kandidimit të tyre në procedura të shpallura më parë për ngritje në detyrë apo për lëvizje paralele. Ndërsa pritet të fillojë procedura e vlerësimit për periudhën e gradimit (2013-2016) që përbën edhe vlerësimin e parë për efekt të ngritjes në detyrë, pas dërgimit të dosjeve nga organet e vetingut për 4 gjyqtarë dhe procedura e vlerësimit të përshpejtuar të detyruar sipas nenit 97 të Ligjit “Për statusin” për 15 gjyqtarë, procedurë që ende nuk ka filluar për shkak të mos përfundimit të procedurës së verifikimit të plotësimit të kriterëve ligjore të kandidimit. Ndërsa për 1 gjyqtare, e cila është e komanduar në Këshill, do të fillojë procedura e vlerësimit sipas rregullave të përcaktuara në vendimin nr. 159, datë 05.04.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Gjithashtu, me vendimet e datës 24.05.2023 janë hapur 8 procedura të lëvizjes paralele në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe Lezhë dhe 3 procedura të lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Për këto procedura kanë filluar më parë vlerësimet për 2 gjyqtarë, dhe pritet të fillojë procedura e vlerësimit të detyruar të përshpejtuar për 1 gjyqtarë, pasi më parë të përfundojë procedura e verifikimit të plotësimit të kriterëve ligjore të kandidimit. Ndërsa për gjyqtarët e tjerë, referuar vendimit nr. 346, datë 27.06.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, janë kualifikuar si gjyqtare që nuk kanë e nuk mund të kenë asnjë vlerësim.

Pasur parasysh numrin e lartë të vlerësimeve të filluara apo që priten të fillojnë për efekt të procedurave të ngritjes në detyrë apo të lëvizjes paralele të shpallura nga Këshilli, konkretisht janë ende të pambyllura 19 procedura të ngritjes në detyrë dhe procedura të lëvizjes paralele nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesioanel në viti 2024, vlerësohet të mos kemi vlerësim etik dhe profesional 5/vjeçar.

Prandaj programi i vlerësimeve të vitit 2024 do të përfshijë përsëri një periudhë 3/vjeçare vlerësimi. Kjo periudhë vlerësimi përkon me periudhën kalendarike 01.01.2020 - 31.12.2022, për gjyqtarët të cilën nuk kanë qenë në program vlerësimit të vitit 2023, si dhe 2021-2023 duke qenë se periudha e vlerësimit përfshin jo vetëm atë vit që ka përfunduar, por edhe atë që përfundon në vitin përkatës në të cilin miratohet programi, në këtë rast në dt. 31.12.2022. Gjithashtu, në këtë program mendohet të futet edhe dy gjyqtarë për të cilën nuk ka filluar më parë vlerësimi periodik për periudhën tre vjeçare të vlerësimit 2017-2019. Konkretisht për gjyqtaren Gentiana Xhelili, e cila ka qenë në programin e vlerësimit të vitit 2021, por për të nuk ka filluar më parë vlerësimi periodik për shkak se ajo është konfirmuar në detyrë në vitin 2023<sup>3</sup>, si dhe për gjyqtarin Kujtim

---

<sup>3</sup> Vendimin datë 03.07.2023 të KPA, i cili ka ndryshuar vendimin nr. 369, datë 21.04.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Vraniçi, i cili nuk ka vlerësime të mëparshme sipas ligjit “Për Statusin”<sup>4</sup> dhe ka më pak se 15 vjet vjetërsi në punë.

Sa më sipër, për periudhën e vlerësimit 01.01.2020-31.12.2022 dhe 2021-2023, do të vlerësohen të gjithë gjyqtarët që kanë mbi 3/vjet përvojë profesionale në dt. 01.01.2023 apo në datë 01.01.2024, jo më shume se 15/vjet përvojë profesionale në dt. 01.01.2023 apo në datë 01.01.2024, dhe të cilët nuk kanë asnjë vlerësim të mëparshme periodike. Nga kjo kategori do të përjashtohen edhe gjyqtarët që i plotësojnë 15/vjet përvojë profesionale përgjatë vitit 2023.

**Lista me gjyqtarët që do të vlerësohen përgjatë vitit 2024, për periudhën e vlerësimit 2017-2019 përbëhet nga :**

**LISTA I**

NR	Gjyqtar	Gjykata	Fillimi i detyrës	Vite Pune
1	{...}	Gj.Shk.1.J.P. Tiranë	26.05.1995 <sup>5</sup>	15 vite
2	{...}	Gj. A. Shk.1. Lushnjë	07.01.2009	14 vite

**Lista me gjyqtarët që do të vlerësohen përgjatë vitit 2024, për periudhën e vlerësimit 2020-2022 përbëhet nga :**

**LISTA II**

NR	Gjyqtar	Gjykata	Fillimi i detyrës	Vite Pune
1	{...}	Gj.Shk.1.J.P. Berat	09.01.2020	3 vite
2	{...}	Gj.Shk.1.J.P. Dibër	09.01.2020	3 vite
3	{...}	Gj.Shk.1.J.P. Sarandë/ caktim i përkohshëm në Gj.Shk.1.J.P. Durrës	09.01.2020	3 vite
4	{...}	Gj.Shk.1.J.P. Durrës	09.01.2020	3 vite
5	{...}	Gj.Shk.1.J.P. Elbasan	09.01.2020	3 vite

<sup>4</sup> Vendimi nr. 701 datë 30.11.2023 “Për mosfillimin e procedurës së vlerësimit për periudhën e gradimit të gjyqtarit Kujtim Vraniçi”

<sup>5</sup> Z.Kujtim Vraniçi është emëruar gjyqtarë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Bulqizë, me vendimin nr.4, datë 26.05.1995 të ish- Këshillit të Lartë të Drejtësisë, dhe ka punuar deri në datë 27.06.2003, kur është liruar nga detyra e gjyqtarit me vendimin nr.141, të ish- Këshillit të Lartë Gjyqësor. Nga data 01.08.2003 – 08.04.2013 dhe nga data 09.05.2013- 11.09.2013 ai ka ushtruar detyrën e ndihmësit ligjor në Gjykatën e Lartë. Me vendimin nr.77, datë 30.06.2014 të ish- Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ai është emëruar në detyrën e inspektorit në ish Inspektoriatin e Lartë të Drejtësisë, ku ka punuar deri në datë 21.11.2016, kur është dekretuar gjyqtar me dekretin nr.9864, datë 21.11.2016 të Presidentit të Republikës.

6	{...}	Gj.Shk.1.J.P. Fier <sup>6</sup>	09.01.2020	3 vite
7	{...}	Gj.Shk.1.J.P. Korçë <sup>7</sup>	09.01.2020	3 vite
8	{...}	Gj.Shk.1.J.P. Kukës <sup>8</sup>	09.01.2020	3 vite
9	{...}	Gj.Shk.1.J.P. Tiranë	09.01.2020	3 vite
10	{...}	Gj. A. Shk.1. Lushnjë	09.01.2020	3 vite
11	{...}	Gj. A. Shk.1. Lushnjë	09.01.2020	3 vite
12	{...}	Gj. A. Shk.1. Tiranë	09.01.2020	3 vite
13	{...}	Gj. A. Shk.1. Tiranë	09.01.2020	3 vite
14	{...}	Gj. A. Shk.1. Tiranë	09.01.2020	3 vite
15	{...}	Gj. A. Shk.1. Tiranë	09.01.2020	3 vite
16	{...}	Gj.Shk.1.J.P. Tiranë <sup>9</sup>	19.07.2019	4 vite

Në këtë listë është përfshirë edhe gjyqtarja Lorena Çabej, e cila ka plotësuar tre vite punë gjatë vitit 2023, por nuk është përfshirë në programin vjetor të vitit 2024.

**Lista me gjyqtarët që do të vlerësohen përgjatë vitit 2024, për periudhën e vlerësimit 2021-2023 përbëhet nga :**

### LISTA III

NR	Gjyqtar	Gjykata	Fillimi i detyrës	Vite Pune
1	{...}	Gj.Shk.1.J.P. Berat	20.10.2020	3 vite
2	{...}	Gj.Shk.1.J.P. Dibër	20.10.2020	3 vite
3	{...}	Gj.Shk.1.J.P. Durrës	20.10.2020	3 vite
4	{...}	Gj.Shk.1.J.P. Elbasan	20.10.2020	3 vite
5	{...}	Gj.Shk.1.J.P. Elbasan	20.10.2020	3 vite
6	{...}	Gj.Shk.1.J.P. Fier	20.10.2020	3 vite
7	{...}	Gj.Shk.1.J.P. Fier/ aktualisht e komanduar në Gjykatën e Lartë <sup>10</sup>	20.10.2020	3 vite
8	{...}	Gj.Shk.1.J.P. Fier <sup>11</sup>	20.10.2020	3 vite

<sup>6</sup> Komanduar në KLGJ me vendimin nr.153, datë 29.03.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

<sup>7</sup> Komanduar si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë me vendimin nr. 434/2020 dt. 14.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për një afat 3/ vjeçar, komandim I cili është zgjatuar me një afat tjetër 1 vjeçar, me vendimin nr. 477, date 13.09.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

<sup>8</sup> Komanduar në Miministrinë e Drejtësisë me vendim nr.538, date 14.12.2022 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me afat komandimi deri ne 01.01.2028

<sup>9</sup> Komanduar si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë me vendimin nr. 433, datë 14.10.2020 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, për një afat 3/ vjeçar, komandim i përfunduar në datë 20.10.2023.

<sup>10</sup> Komanduar si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë me vendimin nr.323, datë 14.06.2023.

<sup>11</sup> Komanduar Këshilltare në ILD, me vendimin nr.50, datë 27.01.2023.



9	{...}	Gj.Shk.1.J.P. Gjirokastrë	20.10.2020	3 vite
10	{...}	Gj.Shk.1.J.P. Kukës	20.10.2020	3 vite
11	{...}	Gj.Shk.1.J.P. Lezhë <sup>12</sup>	20.10.2020	3 vite
12	{...}	Gj.Shk.1.J.P. Sarandë	20.10.2020	3 vite
13	{...}	Gj.Shk.1.J.P. Sarandë	20.10.2020	3 vite
16	{...}	Gj.Shk.1.J.P. Shkodër <sup>13</sup>	20.10.2020	3 vite
17	{...}	Gj.Shk.1.J.P. Tiranë	20.10.2020	3 vite
18	{...}	Gj.Shk.1.J.P. Vlorë	20.10.2020	3 vite
19	{...}	Gj. A. Shk.1. Tiranë	20.10.2020	3 vite

Në këtë listë nuk është përfshirë gjyqtarja Jeta Qinami, e cila pavarësisht se ka tre vite që është caktuar në detyrën e gjyqtarës, nuk ka të paktën 1 (një) vit pune gjatë kësaj periudhe, pasi me vendimin nr. 208, datë 20.05.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është miratuar kërkesa e saj për dhënie leje të papaguar për arsye familjare, për një periudhë 1 (një) vjeçare, leje e cila fillonte më datë 01.06.2021, afat që më pas është zgjatur për një periudhë tjetër deri më datë 12.03.2024, me vendimin nr. 296, datë 30.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Githashtu, në këtë program nuk do të përfshihet gjyqtarja Maela Alicanaj, gjyqtare në Gj.Shk.1.J.P. Fier, aktualisht e komanduar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor<sup>14</sup>, për shkak se sipas Rregullave të Vlerësimit Etik dhe Profesional të Gjyqtarëve të Komanduar në Këshillin e Lartë, të miratuar me vendimin nr.159. datë 05.04.2023<sup>15</sup>, periudha e vlerësimit për gjyqtarët e komanduar në Këshilli është e njëjtë me afatin/periudhën e komandimit dhe vlerësimi bëhet nga Këshilli pas përfundimit të periudhës së komandimit.

**Lidhur me periudhën e vlerësimit 2017-2019, 2020-2022 dhe 2021-2023** nga lista e dërguar nga Njësia e Burimeve Njerëzore pranë KLGJ-së, konstatohet se veç gjyqtarëve të Listës I, II dhe II, më sipër, nuk ka asnjë gjyqtar tjetër që plotëson së paku 3/vite përvojë profesionale në dt. 31.12.2023 apo për të cilët nuk është filluar procedura e vlerësimit nga ana e Këshillit. Gjyqtarët e emëruar pas vitin 2021, nuk kanë plotësuar ende 3/vite përvojë profesionale për tu bërë subjekte vlerësimi.

### **Veç LISTËS I , II dhe III, programi i vlerësimit për vitin 2024 përmban edhe :**

<sup>12</sup> Komanduar si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë me vendimin nr.321, datë 14.06.2023.

<sup>13</sup> Leje për ushtrimin e veprimtarisë jashtë funksionit, të miratuar me vendimin nr.21, datë 29.03.2022, vendimin nr.238, datë 30.06.2022, si dhe me vendimin nr.549, datë 22.12.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, me afat deri në datë 31.12.2023 dhe me vendimin nr. 731, datë 07.12.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, komanduar në pozicionin e “këshilltar juridik”, në Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut, për një afat deri më 31.12.2024.

<sup>14</sup> Komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 249, datë 09.06.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ndryshuar me vendimin nr.253, datë 07.07.2022.

<sup>15</sup> Vendimi nr.159, datë 05.04.2013 “Për Miratimin e rregullave të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor,” në nenin 6 të tij përcakton se;” 1. *Periudha e vlerësimit për gjyqtarin e*

*komanduar është e njëjtë me afatin/periudhën e komandimit. Ajo fillon në të njëjtën ditë me komandimin dhe përfundon në fund të komandimit, i cili nuk mund të jetë më shumë se pesë vjet. 2. Këshilli kryen vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit të komanduar pas përfundimit të afatit të komandimit. Si rregull, gjyqtari i komanduar vlerësohet vetëm një herë për të gjithë periudhën e komandimit.”*

- 1) Gradimin e gjyqtarëve, të konfirmuar në detyrë me vendim të formës së prerë, për të cilët do të dërgohen në vijim nga organet e rivlerësimit, aktet e vlerësimit të tyre profesional. Për shkak të të njëjtit qëndrim të mbajtur edhe në programin e kaluar, gjyqtarët të cilët janë anëtarë të KLGJ-së, nuk janë përfshirë përsëri në këtë program, pasi e kundërta do t'i vendoste ata në një pozicion jo të përshtatshëm për sa i përket perceptimit të publikut dhe gjyqtarëve të tjerë. Lidhur me fillimin e procedurave të vlerësimit me qëllim gradimi, ato do t'i propozohen për miratim Mbledhjes Plenare, menjëherë me dërgimin e dosjes së vlerësimit nga organet e rivlerësimit, sikundër është vepruar edhe përgjatë vitit 2023. Ndërsa do të jenë pjesë e programit të vlerësimit, me qëllim përcaktimin e nivelit të gradimit, tre ish- anëtarët e Këshillit, të cilëve i përfundoi mandati në datë 12.12.2023<sup>16</sup>.
- 2) Vlerësim të përshpejtuar të detyruar për periudhën e vlerësimit 01.01.2022-31.12.2022, apo 01.01.2023- 31.12.2023, sipas një programi të veçantë që Këshilli do të miratojë në rastet kur kërkohet nga gjyqtari, ngritja në detyrë ose lëvizja paralele, ku siç u sqarua edhe më lartë aktualisht janë hapur së fundi 11 procedura të ngritjes në detyrë dhe 3 procedura të lëvizjes paralele për të cilat ende nuk ka filluar vlerësimi i detyruar.

Pjesë e këtij programi vlerësimi, sikundër edhe në vitet paraardhës, nuk janë kryetarët e gjykatave, sepse aktualisht pjesa më e madhe e gjykatave drejtohen nga zëvendëskryetarët. Një numër i konsiderueshëm i kryetarëve të gjykatave janë shkarkuar gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar. Veç kësaj rrethane, rregullat plotësuese të vlerësimit të veprimtarisë së Kryetarëve nuk janë miratuar ende nga Këshilli. Përcaktimi i listës me kryetarët e gjykatave që do të vlerësohen, mbetet një nga prioritetet e ardhshme të programit të vlerësimit.

### **III Planifikimi 3/mujor i vlerësimeve individuale**

Në lidhje me planifikimet 3/mujore të fillimit të procesit të vlerësimit, në nenin 11 pika 1 të vendimit nr. 263, dt 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve”, është përcaktuar se : *“Këshilli miraton brenda muajit nëntor të çdo viti, programin vjetor të vlerësimeve etike dhe profesionale. Programi vjetor përmban, për aq sa është e mundur, edhe planifikimin tremujor të vlerësimeve individuale, duke garantuar një organizim efikas të procedurave të vlerësimit si dhe lehtësimin e zhvillimit të shortit.*

Në zbatim të dispozitës së mësipërme, planifikimet 3/mujore të vlerësimeve bëhen pjesë e programit të vlerësimit, për aq sa është e mundur. Duke marrë në konsideratë situatën në të cilën ndodhen gjykatat për shkak të procesit të rivlerësimit kalimtar, vendet vakante që janë hapur dhe mund të hapen, kërkesat për ngritje në detyrë apo lëvizje paralele etj, KLGJ vlerëson që planifikimet 3/mujore të vlerësimeve të miratohen me vendim të veçantë të Këshillit, mbi bazën e të cilit do të fillojë edhe procesi i vlerësimit për secilin

---

<sup>16</sup> Gjyqtarët Brikena Ukperaj, Dritan Hallunaj dhe Marcela Shehu.

gjqtar, duke mos u ndarë në 3 programe të veçanta 3/mujore, kjo për shkak të numrit të gjyqtarëve të planifikuar për tu vlerësuar gjatë vitit 2023, sipas tabelës I, II dhe III.

#### **IV Prioritetet e planifikimeve 3/mujore**

Prioritetet e planifikimeve 3/mujore të programit të vlerësimit 2023, janë si më poshtë :

1. Kryerjen me përparësi të të gjitha vlerësimeve me procedurë të përshpejtuar të detyruar, sipas neneve 22 dhe 23/b të vendimit nr. 263, dt 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve”;
2. Gradimin e gjyqtarëve të cilët kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar me vendim të formës së prerë, bazuar kjo në nenin 23/a të vendimit nr. 263, dt 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve” dhe nenin 171/5 të Ligjit “Për Statusin, gradim i cili fillon menjëherë me dërgimin e dosjeve nga organet e rivlerësimit ;
3. Vlerësimin e gjyqtarëve të komanduar si ndihmësmagjistratë apo atyre të komanduar në Këshill, në rast aplikimi prej tyre për ngritje në detyrë apo lëvizje paralele;
4. Vlerësimin normal për periudhën 01 Janar 2017 – 31 Dhjetor 2019 të të gjithë gjyqtarëve të Listës I
5. Vlerësimin normal për periudhën 01 Janar 2020 – 31 Dhjetor 2022 të të gjithë gjyqtarëve të Listës II.
6. Vlerësimin normal për periudhën 01 Janar 2021 – 31 Dhjetor 2023 të të gjithë gjyqtarëve të Listës II.

#### **Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale**